



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/343
Datë: 11/5/2018

Mbështetur në kompetencat e përcaktuara me nenin 173, paragrafi 8 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Senati i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e datës 10.05.2018, miratoi:

RREGULLOREN

Për korrigjimet teknike të Rregullores Nr. 990, dt. 19.04.2018 për ekuivalentimin e gradave dhe procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, dhe avancimin e personelit akademik në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"

Rregullorja Nr. 990, dt. 19.04.2018_korrigjohet teknikisht si në vijim:

Neni 1

Teksti në nenin 11, paragrafi 13 i Rregullores bazike aktualisht ka këtë përmbajtje:

- 1.1. Dokumentacioni i shtypur duhet të dorëzohet në Fakultetin përkatës kurse versioni elektronik në adresën zyrtare të Universitetit të Prishtinës (punesimi.akademik@uni-pr.edu).

Teksti në nenin 10, paragrafi 13 i Rregullores bazike korrigjohet si në vijim:

- 1.1. Dokumentacioni i shtypur duhet të dorëzohet në Fakultetin përkatës kurse versioni elektronik në adresën zyrtare të Universitetit të Prishtinës (punesimi.akademik@uni-pr.edu).

Neni 2

Teksti në nenin 12, paragrafi 21 i Rregullores bazike aktualisht ka këtë përmbajtje:

- 2.1. Komisioni vlerësues është i obliguar të shkruajë raport edhe për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet minimale por të cilët nuk janë propozuar të emërohen. Për kandidatët të cilët i nuk plotësojnë kushtet minimale mjafton të ceken kushtet të cilat nuk është plotësuar.

Teksti në nenin 12, paragrafi 21 i Rregullores bazike korrigjohet si në vijim:

- 2.2. Komisioni vlerësues është i obliguar të shkruajë raport edhe për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet minimale por të cilët nuk janë propozuar të emërohen. Për kandidatët të cilët i nuk plotësojnë kushtet minimale mjafton të ceken kushtet të cilat nuk janë plotësuar.

Neni 3

Teksti në nenin 12, paragrafi 25 i Rregullores bazike aktualisht ka këtë përmbajtje:

- 3.1. Anëtarët e komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit dhe për rekomandimet që bëjnë.

Teksti në nenin 12, paragrafi 25 i Rregullores bazike korrigohet si në vijim:

- 3.1. Anëtarët e komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit dhe për rekomandimet që bëjnë do të sanksionohen sipas kodit të etikës dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi, nëse të njëjtat bien qartazi ndesh me Statutin e UP-së dhe këtë Rregullore.

Neni 4

Teksti në Shtojca I, Vërejtje (nën tabelën I.4) në Rregulloren bazike aktualisht ka këtë përmbajtje:

- 4.1. *Vërejtje: Për aktivitetet në D kandidatët në marrëdhënie të rregullt pune në UP duhet të ofrojnë dëshmi që kanë vijuar me sukses së paku 2 trajnime për mësimdhënie (përgjashtimisht konkursit të parë pas miratimit të kësaj rregulloreje).*

Teksti në Shtojca I, Vërejtje (nën tabelën I.4) në Rregulloren bazike korrigohet si në vijim:

- 4.1. *Vërejtje: Për aktivitetet lidhur me tabelën I.4 kandidatët në marrëdhënie të rregullt pune në UP duhet të ofrojnë dëshmi që kanë vijuar me sukses së paku 2 trajnime për mësimdhënie (përgjashtimisht konkursit të parë pas miratimit të kësaj rregulloreje).*

Neni 5

- 5.1. Teksti tjetër i Rregullores bazike mbetet i pandryshuar.
- 5.2. Rregullorja me korrigjimet e sipërshënuara hynë në fuqi ditën e miratimit nga Senati.
- 5.3. Kjo Rregullore është pjesë përbërëse e Rregullores bazike Nr. 990, dt. 19.04.2018.



Prof.dr. Mëhmet Dema, Rektor

Kryesues i Senatit